- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti kontraktor përllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):**
_____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	cmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmblidhjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR UNIFORMA DHE PAISJE PUNE:

1.Xhaketa e dokut për zjarrfikësit

Materiali: Xhaketa duhet të jetë e punuar nga material 100% pambuk i tkurrur, i cili ofron qëndrueshmëri dhe rezistencë ndaj temperaturave të larta.

Dizajni: Në pjesën e përparme, në anën e majtë, në lartësinë e gjoksit, duhet të jenë të qendisura inicialet e emrit të punonjësve. Në krahun e majtë të mëngës duhet të jetë stema e

shërbimit të zjarrfikësve. Në krahun e djathtë të xhaketës, në pjesën e sipërme, duhet të jetë e vendosur grada e punonjësit. Operatori ekonomik, përpara realizimit të xhaketës, duhet të paraqitet për të identifikuar gradat e punonjësve që duhet të vendosen në veshje.

Përmasat dhe përshtatja: Xhaketa duhet të ketë përmasa të përshtatshme për të siguruar lëvizshmëri dhe rehati gjatë operacioneve, duke mos penguar veprimet e zjarrfikësit. Operatori ekonomik duhet të vijë për të marrë masat e punonjësve të MZSH-së.

Elemente reflektuese: Xhaketa duhet të ketë shirita fosforeshent dhe në pjesën e pasme të kurrit të jetë e shkruar fjala “Zjarrfikës”. Shkronjat e fjalës “Zjarrfikës” duhet të jenë fosforeshente.

Rezistenca ndaj ujit dhe kimikateve: Materiali duhet të trajtohet për të ofruar rezistencë ndaj ujit dhe substancave kimike të zakonshme që mund të hasen gjatë operacioneve të zjarrfikjes.

Ngjyra: Blu e errët, përputhje me standardet e uniformës së zjarrfikësve.

2. Pantallona Dimërore

- **Shtresa e jashtme:** Material rezistent ndaj flakës dhe nxehtësisë, që ofron mbrojtje kundër ekspozimit të drejtpërdrejtë ndaj zjarrit.
- **Barriera e lagështisë:** Membranë e papërshkueshme nga uji, e cila parandalon depërtimin e ujit dhe lejon avullimin e djersës, duke ruajtur thatësinë dhe rehatinë.
- **Shtresa e brendshme (rreshtimi):** Pëlhurë e përzier me aramid dhe viskozë, rezistente ndaj flakës, që ofron izolim termik dhe rehati për përdoruesin.

Dizajni dhe veçoritë:

- Pantallonat duhet të kenë një zinxhir të qëndrueshëm, rezistent ndaj flakës.
- Xhepa të pozicionuar në pjesën anësore mbi kupën e gjurit, për mbajtjen e pajisjeve esenciale gjatë operacioneve, si dhe xhepa në pjesën sipër të pantallonit, xhepa në pjesën e pasme të pantallonit.
- Shirita fosforeshent afër fundit të pantallonit.

Përshtatja dhe masat:

- Për masat e realizimit të pantallonit, operatori ekonomik duhet të paraqitet pranë bashkisë për marrjen e masave të stafit të MZSH-së.

Standardet dhe certifikimet:

- Pantallonat duhet të përmbushin standardet ndërkombëtare për pajisjet mbrojtëse të zjarrfikësve.

Ngjyra:

- Blu e errët, përputhje me standardet e uniformës së zjarrfikësve.

3.Pantallona Verore

- **Materiali:** Përdorimi i materialeve të lehta, si përzierje pambuku dhe poliesteri, për të siguruar ventilim dhe qëndrueshmëri.

Dizajni:

- o Prerje klasike me katër xhepa: dy xhepa anësore në pjesën e poshtme të pantallonit, dy xhepa të pasmë dhe dy xhepa klasikë të përfshirë në pjesën e përparme.
- o Rrip me përforcim të brendshëm dhe vegeza për rripin, për të siguruar përshtatje të qëndrueshme.
- o Mbyllje në bel me kapëse metalike dhe zinxhir plastik 22–24 cm në pjesën e përparme.
- o Shirita fosforeshentë për identifikim.

Ngjyra:

- Ngjyrë blu e errët, në përputhje me standardet e uniformës së zjarrfikësve.

Përmasat:

- Për masat e realizimit të pantallonit, operatori ekonomik duhet të paraqitet pranë bashkisë për marrjen e masave të stafit të MZSH-së.

Astar:

- Astar xhepi në ngjyrë të errët, material tekstili, për qëndrueshmëri dhe estetikë.

Elemente shtesë:

- o Penjë qepje në ngjyrë blu të errët për një pamje uniforme.
- o Kapëse metalike "mashkull" – "femër" për mbylljen në bel.
- o Zinxhir me dhëmbëza plastike 22–24 cm për pantallona.

4. Bluze me mëngë të gjata

- **Materiali:** Pëlhurë 100% pambuk e tkurrur, e cila ofron qëndrueshmëri dhe rezistencë ndaj temperaturave të ulta.

Dizajni:

- Prerje klasike me mëngë të gjata.
- Mbyllje me kopsa në pjesën përpara, sipas modelit klasik, në përputhje me standardin e uniformës së zjarrfikësve.
- Në pjesën e sipërme të jetë.
- Në pjesën e pasme të ketë shkrimin “Zjarrfikës”, shkronjat të jenë fosforeshente.
- Në krahun e majtë të bluzës, në pjesën e përparme, të jenë inicialet e emrit të punonjësit të MZSH-së.
- Në krahun e djathtë të bluzës, në pjesën përpara, të jetë grada.
- Në mëngën e majtë të bluzës të jetë stema e MZSH-së.

Ngjyra:

- Ngjyrë blu e errët, në përputhje me standardet e uniformës së zjarrfikësve.

Elemente reflektuese:

- Në pjesën e pasme të bluzës të jetë “Zjarrfikës” me shkronja fosforeshente.

Standardet dhe certifikimet:

- Përputhshmëri me standardet ndërkombëtare për veshjet mbrojtëse.

5. Bluze me mëngë të shkurtra

- **Materiali:** Pëlhurë 100% pambuk e tkurrur, e cila ofron qëndrueshmëri dhe rezistencë ndaj temperaturave të larta.

Dizajni:

- Prerje klasike me mëngë të shkurtra.
- Mbyllje me kopsa në pjesën përpara, sipas modelit klasik, në përputhje me standardin e uniformës së zjarrfikësve.
- Në pjesën e pasme të ketë shkrimin “Zjarrfikës”, shkronjat të jenë fosforeshente.
- Në krahun e majtë të bluzës, në pjesën e përparme, të jenë inicialet e emrit të punonjësit të MZSH-së.

-
- Në krahun e djathtë të bluzës, në pjesën përpara, të jetë grada.
 - Në mëngën e majtë të bluzës të jetë stema e MZSH-së.

Ngjyra:

- Ngjyrë blu e errët, në përputhje me standardet e uniformës së zjarrfikësve.

Elemente reflektuese:

- Në pjesën e pasme të bluzës të jetë “Zjarrfikës” me shkronja fosforeshente.

6.Këpucë kambale

Këpucët me qafa dimërore duhet të jenë të realizuara nga elemente prej lëkure dhe gome dhe të përbëhen nga këto pjesë dhe aksesore:

- Faqet e këpucës (faqe e përparme dhe faqet anësore);
- Maja;
- Përforcues i brendshëm;
- Astar i brendshëm;
- Thembra, shtroja (mbështetësja), shollë.

**7.Kapelë**

Kapela duhet të jetë dok, blu e errët, e qepur me pëlhurë blu të errët.

Materialet ndihmëse që duhen të përdoren për prodhimin e artikullit “kapelë” janë:

- Dok, blu e errët;
- Penjë qepje, me ngjyrën e dokut;
- Stema e kapelës.



8. Logo Zjarrëfikse → të jetë në përputhje me foton bashkëngjitur specifikimeve



9. Logo Mbiemeri → të jetë në përputhje me foton bashkëngjitur specifikimeve



10. Gradë Zjarrëfikse → të jetë në përputhje me foton bashkëngjitur specifikimeve



11.Kundra gaz profesional për fytyrën

- **Materiali:**

- **Trupi i maskës:** Silikon ose gomë nitrile rezistente, e cila siguron një vulë hermetike dhe mbrojtje ndaj kimikateve dhe nxehtësisë.

- **Vizori:** Polikarbonat i qëndrueshëm ndaj gërvishtjeve dhe goditjeve, duke ofruar një pamje të qartë dhe të zgjeruar.

Sistemi i Filtrimit:

- Dy filtra anësorë (të zëvendësueshëm) me karbon aktiv dhe një sistem filtrimi për grimcat e rrezikshme.

- **Standard i filtrave:** Mund të jetë EN 14387, që siguron mbrojtje ndaj gazrave organikë, avujve të dëmshëm dhe grimcave toksike.

- Valvula e frymëmarrjes për reducimin e rezistencës së ajrit dhe eliminimin e dioksidit të karbonit.

Sistemi i Ventilimit:

- Ka një valvul qendrore të shkarkimit të ajrit për të parandaluar grumbullimin e dioksidit të karbonit dhe lagështisë brenda maskës.

Komoditeti dhe Përshtatshmëria:

- Rripa elastikë të rregullueshëm për një përshtatje të sigurt në forma të ndryshme të fytyrës.
- Dizajn ergonomik për përdorim të gjatë pa shkaktuar lodhje.

**12.Hedhëse uji profesionale 50mm Storz C**

- **Lloji:** Hedhëse uji profesionale me lidhje Storz C (50 mm)
- **Diametri nominal i daljes:** 50 mm (2 inç)
- **Presioni maksimal i punës:** 16 bar
- **Presioni i testimit:** >20 bar
- **Gama e rrezes së spërkatjes:** 20 - 35 metra, varësisht nga presioni i ujit
- **Lidhja:** Standard Storz C, e përshtatshme për gypa zjarrfikësësh me këtë lidhje
- **Materiali:**
 - **Trupi:** Alumin i anodizuar ose bronz i qëndrueshëm për rezistencë ndaj korrozionit
 - **Doreza:** Plastikë e fortë ose metal për kontroll më të lehtë
 - **Venti i brendshëm:** Gome silikon rezistente ndaj temperaturave të larta dhe presionit

Opsionet e Rregullimit të Rrymës së Ujit:

- **Rrymë e drejtpërdrejtë (jet e ngushtë):** Për distancë maksimale të ujit
- **Rrymë e përhapur (spërkatje e gjerë):** Për mbulim më të madh
- **Modaliteti "shut-off":** Ndalon rrjedhjen e ujit për kursim dhe kontroll më të mirë



13.Uniforma zjarrëdurese

Xhaketa dhe pantallonat

- Xhaketa dhe pantallonat për mbrojtje nga zjarri duhet të jenë të punuara dhe të certifikuara në përputhje me standardin EN 469:2005, niveli 2 i mbrojtjes.
- Prodhuesit ose subjekti që i trajton këto produkte duhet të paraqesë certifikatat e vlefshme të produktit.

Xhaketë

- Në pjesën e pasme, lart, xhaketa duhet të ketë një shirit me përmasa 15 cm në lartësi dhe gjerësi sa ajo ndërmjet gaturave.
- Ngjyra e shiritit do të jetë gri metalizato, mbi të cilin do të shkruhet “MZSH” me shkronja blu të errët, lartësia 10 cm dhe gjerësi 1.8 cm.
- Në pjesën e përparme të xhaketës, duhet të ketë një xhep për radiomarrës, i vendosur 2 cm majtas nga shiriti i përparmë, dhe një shirit me dimensione 7.5x3 cm mbi xhep.
- Xhaketë do të ketë xhepa të përparme dhe të pasme të fiksuar me velcro.
- Xhaketa duhet të ketë gjithashtu një hapje për riparim në pjesën e shpinës (54 cm) dhe në anën e djathtë (28 cm).

Pjesa e Shpinës

- Pjesa e shpinës duhet të jetë e ndarë horizontalisht dhe mbishkrimi duhet të jetë i shkruar me shkronja 6 cm, me ngjyrë argjendte mbi sfond të verdhë flourishente.
- Shkrimi mund të jetë “MZSH” ose ndonjë mbishkrim tjetër sipas marrëveshjes.
- Mbishkrimi mund të jetë i qëndrueshëm me velcro ose përhershëm.

Xhepat anësore

- Xhepat anësore duhet të jenë të mbuluar me kapakë (22x7.5 cm) dhe mbyllen me velcro.
- Në kapakët e xhepave duhet të vendoset një karabinë me kokë rrotulluese.

Astarimi dhe materialet

- Xhaketa do të jetë e pajisur me astar të përhershëm të rezistent ndaj zjarrit.
- Xhepi i brendshëm duhet të jetë i vendosur në anën e djathtë të astarit, me përmasa 18x2 cm, mbyllur me velcro.

Materialet

- Materiali i jashtëm duhet të jetë një përzierje e fijeve të aramidi (100%) dhe ngjyra e materialit do të jetë blu e errët, ngjashëm me RAL 5004.
- Membrana mikroporoze PTFE do të përdoret për pengimin e depërtimit të fluideve.
- Pjesët që përfshijnë shiritat e mbrojtjes dhe përforcimet duhet të jenë të certifikuara sipas standardeve EN 469 dhe EN 532.

Aksesorët dhe Detajet e tjera


- Zinxhiri i xhaketës do të ketë patentë paniku dhe dhëmbë metalik me madhësi 8mm.
- Velcro për mbyllje dhe shirita elastikë për rregullimin e pjesëve të ndryshme.
- Jaka dhe bërrylat do të kenë përforcime dhe mund të rregullohen me shirita.
- Xhep për thikë dhe xhepa anësore me kapakë me mbyllje velcro.

Pantallonat

- Pantallonat duhet të jenë të certifikuara sipas standardeve EN 469 dhe të kenë shtrat të lartë dhe brezi të përshkruar brenda me llastik për përshtatje të mirë.
- Xhepat e pantallonave duhet të jenë të pajisur me mbërthim velcro dhe mund të kenë shtesa për thikë dhe tjera.

Këmbët e Pantallonave

- Këmbët duhet të jenë të pajisura me përforcime të materialeve të silikonit/karbonit për mbrojtje shtesë.
- Jastëkët ergonomikë do të jenë të punuar nga materiale që nuk thithin lagështi dhe janë të qëndrueshme ndaj flakës.



14.Dorashka zjarëduruese

Struktura/përbërja:

Strukturë e papërshkueshme nga uji

Duhet të jenë absolutisht të papërshkueshme nga uji dhe të kenë aktivitet të lartë ajrosjeje, të cilin duhet t'ia ofrojë membrana;

Duhet të jenë të punuara nga materiale të teknologjisë së lartë;

Mbrojtje ekstreme nga konsumimi në pjesën e brendshme të dorës;

Të garantojnë mbrojtje nga të nxehtit dhe të ftohtit;

Pjesa e pasme e dorës duhet të jetë e punuar në mënyrë të veçantë që të lejojë punë optimale pa tension;

Duhet të ketë izolim të dyfishtë në zonën e ekspozuar, sidomos pjesën e pasme të dorës;

Mbrojtje shtesë të gishta nga materiali Kevlar, të përforcuar me materiale shtesë.



15.Kostum kundër ujit me çizme të integruara

- **Materiali:** PVC i fortë ose Neoprene/Najlon me veshje gome, i papërshkueshëm nga uji dhe kimikatat
- **Trashësia e materialit:** 0.8 - 1.2 mm për rezistencë të lartë ndaj grisjeve dhe konsumimit
- **Qepje të salduara me ultratinguj** për mbrojtje maksimale ndaj rrjedhjeve të ujit
- **Izolim termik** për mbrojtje në temperatura të ulëta

Çizmet e Integruara:

- **Material:** Gome natyrale ose PVC i qëndrueshëm ndaj rrëshqitjes
- **Taban kundër rrëshqitjes** me model anti-skid për mbajtje të mirë në sipërfaqe të lagështa
- **Forcim shtesë** në majë dhe thembër për mbrojtje nga goditjet

Përshtatja dhe Rehatia:

- **Rripa elastikë në sup** me rregullim të shpejtë për përshtatje të mirë
- **Dizajn i gjerë dhe fleksibël** për lëvizje të lirshme
- **Hyrje e lartë** (deri në kraharor) për mbrojtje maksimale nga uji
- **Pesha:** 2-3 kg varësisht nga materiali dhe madhësia



16.Helmeta Profesionale

Helmeta duhet të jetë e pajisur me një amortizues të punuar nga poliuretani, i cili duhet të jetë i integruar në gëzhhojën e helmetës dhe nuk mund të hiqet. Në mes të gëzhhojës, e cila duhet të jetë e punuar nga materiale kompozite (fibra karboni), dhe poliuretanit (i integruar në poliuretan), duhet të jetë e integruar një gëzhhojë e dytë dhe një shkumë izoluese.

Pjesa e brendshme e helmetës

Duhet të jetë e punuar nga materiale kompozite SMC (nuk lejohen pjesë plastike për përforcime).

Për t'iu përshtatur kokës, rregullimi i madhësisë së helmetës duhet të bëhet përmes një rregullatori, i cili duhet të mundësojë ndryshimin e madhësisë nga 52–64 cm.

Gjerësia e jashtme e helmetës duhet të jetë mes 236 mm–247 mm në zonën e veshëve,

gjatësia nuk duhet të tejkalojë 316 mm dhe lartësia nuk duhet të tejkalojë 216 mm.

Helmeta duhet të jetë ngjyrosur me ngjyrë lumineshente.

Të dyja anët e helmetës duhet të pajisen me nga një shirit reflektues që shtrihen pothuajse përgjatë gjithë helmetës.

Gjerësia e shiritit duhet të jetë mes 24 mm–25 mm.

Helmeta duhet të jetë e pajisur me një mbrojtës qafe të punuar prej fibrave karbonike dhe të trajtuara me alumin.

Mbrojtësi duhet të lidhet me helmetën përmes 3 pikave dhe duhet të jetë i lehtë për t'u hequr dhe instaluar.

Helmeta duhet të mundësojë përdorimin e papenguar të maskës së aparatit të frymëmarrjes.

Pesha totale, së bashku me mbrojtësin e qafës, nuk duhet të jetë më e madhe se 1,4 kg.

Në pjesën ballore të helmetës duhet të jetë përcaktuar vendi për logo. Madhësia e vendit për logo duhet të jetë e gjerë rreth 65 mm–80 mm, ndërsa lartësia duhet të jetë mes 65 mm–75 mm. Logoja e përdoruesit të fundit duhet të jetë e shtypur fabrikisht në anën e përparme të helmetës. Nuk lejohet ngjitja e etiketave plastike (stickers).

Helmeta duhet të jetë rezistente në temperaturë deri në 1000°C për një periudhë kohore prej së paku 10 sekonda, në kontakt me fenomenin "Flash over", si dhe e testuar në temperaturë 250°C për 30 minuta.

Helmeta duhet të ofrojë mbrojtje të plotë të kokës, duke përfshirë edhe qafën dhe fytyrën.

Ripi i mjekrës duhet të jetë nga materiali Nomex dhe i testuar për të mos shkaktuar irritime (alergji).

Helmeta duhet të jetë e pajisur me llambë ndriçuese Xenon dhe mbajtës përkatës, si dhe të mundësojë vendosjen e sistemit të komunikimit.



Për zjarrfikësin operues

Për drejtuesin/komandantin e zjarrfikësit

17.Këmisha të bardha për zyrën me një ndalesë:

Duhet të jetë bazike, me përmasa oversize, e përshtatshme për punonjësit e zyrës me një ndalesë në bashki. Materiali: pambuk.

18.Pantallona klasike për zyrën me një ndalesë:

Ngjyrë e zezë (4 palë masa Medium, 4 palë masa Large). Materiali: pambuk.

19.Xhaketë e zezë klasike për zyrën me një ndalesë:

Bazike, me masa standarde, e përshtatshme për punonjësit e zyrës me një ndalesë. Materiali: pambuk.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

OBJEKTI : “Uniforma dhe pajisje pune ”

Nr	Emrtimi	Njesia	Sasia
1	Khaket Doku	Copë	12
2	Pantallona Dimërore	Palë	12
3	Pantallona Verore	Copë	12
4	Bluzë me mëngë të gjata	Copë	22
5	Bluzë me mëngë të shkurtra	Copë	22
6	Kepucë kambale	Palë	14
7	Kapele	Copë	14
8	Logo Zjarrëfikse	Copë	14
9	Logo Mbiemeri	Copë	14
10	Gradë Zjarrefikse	Copë	14
11	Kundra gaz profesional për fytyren	Copë	4
12	Hedhëse uji profesionale 50mm Storz C	Copë	2
13	Uniforma zjarrëduruese	Copë	2
14	Dorashka zjarrëduruese	Palë	8
15	Kostum kundër ujit me çizme të	Palë	2

	integruara		
16	Helmet Profesionale	Copë	8
17	Këmisha të bardhë për zyrën me një ndalesë	Copë	8
18	Pantallona klasike të zeza për zyrën me një ndalesë	Copë	8
19	Xhaketë e zezë klasike për zyrën me një ndalesë	Copë	8

		Afati 1 Muaj
NR	EMERTIMI I PUNIMEVE	Afati në muaj
		I
1	Uniforma dhe pajisje pune	

Afatet e lëvrimit: **Fillon nga data e nënshkrimit të kontratës dhe mbaron deri më 1 (një) muaj.**

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 8 dhe 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së perlologaritur të kontrates, perkatesisht **489 040 lekë pa tvsh.**

Kriteri konsiderohet i përmbushur nese operatorët ekonomik arrijne vleren e xhiros minimale ne te pakten 1 (nje) vit te periudhes se kerkuar te viteteve financiare.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në perputhje me Ligjin nr.10091 date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 në zbatim të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes se Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 ne DST.

2.3 Kapaciteti teknik:

Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi dëshmi për furnizime të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit ku vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës përkatesisht: **244 520 leke pa TVSH.**

2.3.1 Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Per kontratat e realizuar si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese: Kontraten e bashkimit te operateve te deklaruara ne fazen e tenderimit.

2.4 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatë të vlefshme: **ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) / ekuivalente dhe e vlefshme** e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

2.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëse është prodhues ose distributor i autorizuar nga prodhuesi për artikujt për këtë objekt prokurimi ose është subjekt tregtar i artikujve objekt prokurimi i autorizuar nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar i Prodhuesit.

Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Autorizim Prodhuesi ose Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, për artikujt objekt prokurimi. Ne rast se do te paraqitet Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, duhet te provohet edhe lidhja midis Prodhuesit dhe Distributorit te autorizuar.

Secili nga dokumentat duhet te jete i vlefshem, nese eshte ne gjuhe te huaj duhet te jete i perkthyer ne shqip dhe i noterizuar, si dhe te permbaje te dhena te plota te prodhuesit ose distributorit te autorizuar si: tel, fax, email, website, etj., kjo e nevojshme per AK ne rast verifikimi nga ana e tij.

2.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se merr përsipër realizimin e këtij objekti prokurimi sipas preventivit dhe specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

2.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë dhe të marr përsipër marrjen e masave trupore të të gjithë punonjësve të Bashkise Roskovec për artikujt objekt prokurimi.

2.8 Referuar pikës 1 të nenit 26 të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82 të LPP-së i ndryshuar dhe në këto rregulla”,* si dhe përcaktimet e pikës 6 të këtij neniku parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9.*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
 _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	_____
Numri NIPT/et:	_____
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	_____
Përfaqësuesi (emri):	_____
Telefoni:	_____
E-mail:	_____

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar
------------------------	---------	-----------------------------	---

të propozuar				• nformacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik
Emri (at) e subjekteve				
NIPT-i				
Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik				
Specifiko konkretisht kapacitetin/et				

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁶.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

⁶ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrent” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

